

**STATUTI
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
"VITA PRODUCTION" SHPK**

Sot më datë 28.05.2025, në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", godina ETC, kati 12, zyra 5, Tirane, une e nënshkruara:

Zj. Holta Dulaku, shtetase shqiptare, lindur më 16.04.1974, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal H45416057U, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar

me vullnetin tim të plotë dhe lirë, përmes këtij akti, themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë Statut.

**NENI 1
THEMELIMI DHE EMERTIMI**

Personi i sipërpërmendur nëpërmjet këtij akti vendos të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të quajtur "VITA PRODUCTION" SH.P.K., (më poshtë e quajtur "Shoqëria") në përputhje me ligjin shqiptar nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar (këtu e më poshtë i quajtur edhe Ligji).

**NENI 2
PERSONALITETI JURIDIK**

Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Shqipëri.

**NENI 3
SELIA DHE KOHEZGJATJA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", godina ETC, kati 12, zyra 5, Tirane, Shqipëri.

Adresa e-mail është: leonard.bego@yahoo.com.

Nr. I telefonit është: 0692078120

Shoqëria mund të hapë dhe të kryejë aktivitet në vende të tjera, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Administratori është përgjegjës për hapjen e njësitë dytësore të aktivitetit të shoqërisë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

**NENI 4
KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 Leke (Njëqind Leke) i përbeherë nga 1 (nje) kuote.
2. I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar nga Ortaku si në vijim:

Zj. Holta Dulaku, ka nënshkruar një kuotë me vlerë 100 Leke (njëqind Leke) që përben 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Ortaku ka paguar vlerën e kapitalit themeltar.




3. Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe mund të transferohet në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë statut dhe atyre të parashikuara nga ligji shqiptar.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Prodhim dhe shperndarje i veprave audiovizuale, filma te metrazhit te gjate, te shkurter dhe te animuar. Prodhimin dhe shitjen ne menyre dixhitale te produkteve dhe sherbimeve audio e video. Prodhim dhe distribucion i programeve te ndryshme audiovizive dhe i video-audio kasetave ne formate te ndryshme, profesionale ose jo, bashkepunimin me rrjete audiovizive vendase dhe te huaja dhe perfaqesimin reciprok te tyre si dhe aktivitete te tjera te lidhura ose plotesuese me ato te parat dhe cdo aktivitet tjeter te nevojshem ose te dobishem per ushrimin e veprimtarise audiovizive. Organizimin e aktiviteteve artistike, muzikore, teatrale, kinematografike dhe audiovizuale te çdo lloji ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj. Organizimin e spektakleve, shfaqjeve teatrale, sfilatave te modes, produksioneve, video dhe audio. Prodhimin dhe shitjen e spektakleve audiovizive, shfaqjeve teatrale, shfaqjeve, dokumentareve televiziv, reklamave si dhe shperndarjen e tyre ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj. Zhvillimin dhe ndermjetesimin e projekteve per aktivitete te ndryshme te shoqerive me aktivitet artistik, muzikor, teatral, kinematografik dhe audiovizual te cdo lloji ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj. Sigurimin e projekteve artistike, muzikore, teatrale, kinematografike dhe audio-vizuale dhe nenshkrimin e kontratave afatgjata per realizimin e ketyre projekteve. Ndermjetesimin, nxjerrjen dhe perpunimin e materialeve artistike, muzikore, teatrale, kinematografike dhe audio-vizuale te te gjitha llojeve, veprimtari, sherbime, etj. Kontaktimin me persona fizike dhe juridike, vendas ose te huaj, per gjetjen e tregjeve te blerjes dhe shitjes per prodhimet artistike te te gjitha llojeve, te shoqerise dhe shoqerive te tjera. Prodhimin dhe shperndarjen e dokumentareve te ndryshem audioviziv, shkencor, kulturor, dhe cdo tematike tjeter, per promovimin e vlerave historike kombetare dhe/ose nderkombetare. Organizime dhe menaxhime aktivitetes per dite te rendesishme, seminare, konferenca, dasma, ditelindje, pervjetore, perurime dhe ngjarje te tjera te rendesishme ne te gjitha komponentet perberes. Prgatitje te ambjenteve per organizime te tilla apo te ngjashme. Menaxhimin e sherbimeve katering (sherbim gastronomik ne ambientet e klienteve sipas porosise se tyre), restorant, bar. Shitblerje, import dhe eksport i te gjitha llojeve te prodhimeve industriale, konfeksioneve, dhe te ngjashme me to.

NENI 6 KËRKESA PËR TË PAGUAR KUOTAT E KAPITALIT DHE TËRHEQJA E KUOTAVE TË PAPAGUARA

- (1) Administratorët mund t'i kërkojnë ortakut të paguajë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat e tij dhe çdo ortak, në varësi të marrjes së një njoftimi prej të paktën, katërbëdhjetë ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e veta, si përcaktohet në njoftim. Thirrja për pagesë mund të kërkojë që pagesa të bëhet me këste. Personi të cilit i drejtohet thirrja për pagesën e kontributit përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së kuotave, me të cilat lidhet thirrja për pagesë.
- (2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote mbajnë përgjegjësi bashkërisht dhe veçmas për të shlyer të gjitha thirrjet për pagesë të kontributit, të cilat lidhen me këtë kuotë.
- (3) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e pashlyer në fund të afatit të vet, personi të cilit i drejtohet thirrja dhe i cili është përgjegjës për pagesën, paguan një interes mbi shumën e papaguar, duke filluar nga dita kur mbaron afati deri në momentin e pagimit me një normë vjetore interesi sipas Bankës se



Shqipërisë.

(4) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratorët mund t'i japin një njoftim prej jo më pak se katërbëdhjetë ditësh të plota personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumuluar. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se nëse nuk zbatohet, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi, përgjigjen duke u anuluar.

(5) Nëse njoftimi nuk zbatohet, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të bëhet pagesa e kërkuar nga njoftimi, mund të tërhiqet me vendim të asamblesë dhe tërheqja përfshin edhe të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e tërhequra dhe të papaguara deri në momentin e tërheqjes.

(6) Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e tërhequr mund të shitet, të rishpërndahet ose të hiqet në bazë të kushteve dhe mënyrës që konsiderojnë të arsyeshme administratorët.

(7) Personi prej të cilit janë tërhequr kuotat e kapitalit pushon së qeni ortak në lidhje me kuotat e tërhequra, por vazhdon të jetë përgjegjës përpara shoqërisë për të gjitha kontributet të cilat janë të pashlyera në datën e tërheqjes së kuotave në lidhje me këto kuota së bashku me interesin e llogaritur me normën e interesit të zbatueshëm për këto kontribute përpara tërheqjes.

NENI 7

KUOTAT, TË DREJTAT DHE KUFIZIMET

Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla, siç përcaktohet në vendimin me shumicë të kualifikuar (me tri të katërtat e votave) të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me Nenin 87 të Ligjit.

NENI 8

CERTIFIKATAT E KUOTAVE TË KAPITALIT

Çdo Ortak, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e certifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët sipas Nenit 72 paragrafi (2) të Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët, renditen në certifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

NENI 9

KALIMI I KUOTAVE ME KONTRATË

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Kalimi i kuotës i njoftohet Shoqërisë në selinë e regjistruar. Administratorët mund të mos pranojnë ta regjistrojnë kalimin e kuotës pranë Regjistratit Tregtar, nëse kuota nuk është shlyer tërësisht ose nëse nuk janë dakord që kuotën ta marrë marrësi në përputhje me procedurën e parablerjes. Nëse Administratorët nuk pranojnë ta regjistrojnë kalimin e kuotës, ata, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në Shoqëri, i dërgojnë marrësit njoftimin për mospranimin.

NENI 10

KALIMI PËRMES TRASHËGIMISË OSE FALIMENTIT

(1) Nëse një ortak vdes, bashkëzotëruesit e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotërues i vetëm ose një bashkëzotërues i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët Shoqëria i njeh si titullarë të kuotës së tij; Por, asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pronësi e ortakut të vdekur



nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.

(2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, mundet që, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga administratorët, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotërues vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos, që të kërkojë, që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës tek ky person tjetër duke marrë parasysh procedurën e parashikuar te parablerjes.

(3) Personi, që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, gëzon të drejtat titullar i të cilave do të kishte qenë si zotërues i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë Regjistrisë Tregtare ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në Asamblesë e Përgjithshme të Shoqërisë.

NENI 11

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

(1) Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin, me vendim të marrë me shumicë të thjeshtë, Gjithashtu edhe rritja e kapitalit me qëllim emetimi të kuotave të reja për shitje tek të tretet do të miratohet me shumicë të thjeshtë.

(2) Me anë të një vendimi me shumicë të thjeshtë, Shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet.

NENI 12

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

(1) Administratori mund të thërrasë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme sipas parashikimeve të Nenit 82 të Ligjit si dhe në çdo rast kur ata e mendojnë të arsyeshme vetë. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret edhe nga ndonjë nga ortakët sipas parashikimeve të nenit 84 ose çdo rasti tjetër të lejuar specifikisht në këtë Statut.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike, që i drejtohet secilit prej Ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të bëhet të paktën shtatë ditë të plota përpara mbledhjes, por kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër nëse këtë e aprovojnë shumica e ortakëve që zotërojnë jo më pak se nëntëdhjetë përqind të kapitalit. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.

(3) Kur Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve mbledhet jo në përputhje me parashikimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, vendime të rregullta mund të merren nëse të gjithë Ortakët që përbëjnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit janë dakord që të merren vendime pavarësisht parregullsisë.


(4) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme me votë pro të tre të katërtave të ortakëve me të drejtë për çështje në lidhje me përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

NENI 13

PUNIMET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

(1) Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, nuk mund të fillojnë nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në Nenin 86 të Ligjit. Ortakët ose zotëruesit e prokurave të votimit mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Nenit 88. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Administratori cakton një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur



procesverbalin e mbledhjes.

(3) Nëse Administratori nuk ka dëshirë të jetë Kryetari i mbledhjes ose nëse nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e vendosur për të mbajtur mbledhjen, Ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen si Kryetar i saj.

(4) Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Me pëlqimin e mbledhjes në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhje të shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e Asamblesë. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të punës që duhen kryer. Përndryshe, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i nevojshëm.

(6) Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë:

I. Kryetari; ose

II. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se pesë përqind të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak, ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.

(7) Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8) Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

NENI 14 **VOTAT E ORTAKËVE**

(1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi, ka të drejtën e një vote.


(2) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.

(3) Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit, vendimi i të cilit është i formës së prerë. Të gjitha votat e pa hequra në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë janë të vlefshme.

NENI 15 **HETIMET E POSAÇME**

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posaçëm sipas Nenit 91 të Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e shoqërisë të një dokumenti së bashku me një deklaratë noteriale, e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

NENI 16 **EMËRIMI I ADMINISTRATORIT**



(1)Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të caktuar, sipas parashikimeve të Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 të Ligjit. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi me shumice të zakonshme i cili, nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.

(2)Administratori i parë i shoqërisë do të jete **Zj. Klea Gina**, shtetase shqiptare, lindur më 11.04.1993, në Lushnje, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J35411054S, i cili do të mbaje këtë mandat për një afat 5 (pese) vjeçar duke filluar nga data e regjistrimit të Shoqërisë.

(3)Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në Nenin 95 paragrafi (2) të Ligjit.

NENI 17

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

1) Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Neni 81 i Ligjit. Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktivë nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund t'i bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të kishin qenë të vlefshme nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishin dhënë direktiva.

(2) Administratori mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre apo të autorizojnë persona të tjerë për të ndërmarrë dhe kryer formalitete të zakonshme të aktivitetit shoqëror duke përfshirë por pa u kufizuar në deklarime dhe pagesa pranë autoriteteve shtetërore dhe shoqërive të utiliteteve (ujë, energji elektrike, etj;

(3)Administratori mund të ndërmarrë dhe kryejë, çdo veprim pa asnjë limit lidhur me:

I. Transaksione dhe/ose pagesa bankare ose të tjera veprime të ngjashme.

II. Lëshojë linja kredie/debie.

III. Nënshkruajnë kontrata, marrëveshje, dokumente bashkëpunimi, deklarata e çdo lloji, ose çdo akt tjetër ligjor.

3.1.Administratori mund të nënshkruajë dhe ndërmarrë veprime edhe pa miratim të Asamblesë së Ortakeve Shoqërisë:

a)për çdo operacion, transaksion, kërkesë, aplikim dhe/ose aktivitet tjetër, që lidhet në përgjithësi për markat e të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale të shoqërisë;

b)çdo lloj akti ligjor, kontrate, marrëveshje, deklarate të çdo lloji që do të ketë lidhje me asetet e shoqërisë.

c)për të ndarë, tjetërsuar apo për të transferuar çdo pasuri apo biznes të shoqërisë.

NENI 18

LARGIMI I ADMINISTRATORIT

(1) Posti i Administratorit lirohet nëse:

1. pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit, përfshirë Nenin 95 paragrafi (6).

2. hyn në procedurën e paaftësisë paguese;

3. vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;

4. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë; ose

5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa leje në mbledhjet e mbajtura gjatë kësaj periudhe nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 19

SHPËRBLIMI I PUNËS, PËRFITIMET E TJERA DHE SHPENZIMET E ADMINISTRATORIT



(1) Administratori ka të drejtë të marrin shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.

(2) Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime, në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata persona të cilët kanë punuar më parë për shoqërinë ose për shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë filiale të shoqërisë ose për shoqëri pararendëse të shoqërisë ekzistuese, ose për familjare të tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish-bashkëshortin ose ish-bashkëshorten) ose për persona të cilët janë në varësi të tyre, dhe mund të japë kontribute në fonde të caktuara për dhënie e përfitimeve të tilla (si përpara ashtu dhe pasi personi në fjalë pushon së mbajturi postin ose marrëdhënien e punës).

(3) Administratorit do ti paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit apo të tjera që u lindin në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme apo mbledhje të veçanta të zotëruesve të klasave të aksioneve të shoqërisë, si dhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre.

NENI 20 **DIVIDENTET**

(1) Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividende me përputhje me të drejtat përkatëse të Ortakëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend, duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.

(3) Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë, nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.

(4) Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është e detyruar ta paguajë.

NENI 21 **KAPITALIZIMI I FITIMEVE**

Asambleja e Përgjithshme dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga Neni 14 i Ligjit, mund të vendosi të kapitalizojë fitimet e paspërndara të shoqërisë, që nuk kërkohen për të paguar dividendë preferenciale ose borxhe të tjera të pashlyera ende nga shoqëria dhe kapitali i detyruar i shoqërisë.

NENI 22 **PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesit me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'i shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

NENI 23 **NJOFTIMET**



(1) Njoftimet që i jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit, duhet të jenë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në Nenin 4 paragrafi (8) të këtij statuti, që është i vlefshëm në momentin që i bëhet e ditur për këtë qëllim personit që bëri njoftimin.

(2) Shoqëria mund t'i japë një njoftim një ortaku ose personalisht ose duke ia nisur me postë në një zarf, për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut ose duke ia lënë në këtë adresë ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut. Kur ka bashkëzotërues të një kuotë, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve në përputhje me Nenin 7, paragrafi (2) i Ligjit.

(3) Në këtë Statut përfshihen shtesa dhe ndryshime dhe të gjithë dokumentet e tjera, raportet, komunikatat dhe procesverbalet e shoqërisë.

NENI 24

Ky Statut përpilohet në 4(katër) kopje origjinale me vlerë të njëjtë ligjore në gjuhën shqipe. Statuti mbyllet me 25(njëzet e pese) nene.

Ky Statut do të shërbej gjithashtu si Akt i Themelimit të shoqërisë së re dhe do të regjistrohet në Regjistrin Tregtar me depozitimin e këtij dokumenti të nënshkruar.

NENI 25

Ngarkohet **Zj. Klea Gina**, shtetase shqiptare, lindur më 11.04.1993, në Lushnje, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J35411054S, për ndjekjen e procedurave ligjore për Regjistrimin e shoqërisë pranë Qendres Kombetare të Bisnesit.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

HOLTA DULAKU

